

CRNA GORA
Opština Tuzi
SKUPŠTINA OPŠTINE
Služba Skupštine
Br/Nr: 02-030/20- 4761
Tuzi/Tuz,29.05.2020. godine

MALI I ZI
Komuna e Tuzit
KUVENDI I KOMUNËS
Shërbimi i Kuvendit

SKUPŠTINA OPŠTINE TUZI

Predmet: Dostava Predloga Programa rada Skupštine opštine Tuzi
Shodno članu 140 stav 2 Poslovnika o radu Skupštine opštine Tuzi ("Službeni list Crne Gore-Opštinski propisi", br. 29/19) u prilogu akta dostavljam Predlog Programa rada Skupštine opštine Tuzi za 2020.godinu.
Za predstavnika predlagača koji će učestvovati u radu Skupštine i njenih radnih tijela prilikom razmatranja ovog materijala određuju se Fadil Kajoshaj predsjednik Skupštine i Nermin Alibašić sekretar Skupštine opštine Tuzi.

Kuvendi i Komunës së Tuzit

Lënda: Dorëzim i Propozimit të Programit të punës së Kuvendit të Komunës së Tuzit
Në pajtim me nenin 140 paragrafi 2 i Rregullores mbi punën e Kuvendit të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 29/19) në shtesë të aktit po Ju dorëzoj Propozimin e programit të Punës së Kuvendit të Komunës së Tuzit për vitin 2020.
Për përfaqësues të propozuesit i cili do të marrin pjesë në punën e Kuvendit të Komunës dhe trupave të saja punuese gjatë shqyrtimit të këtij materiali caktohen Fadil Kajoshaj kryetar i Kuvendit dhe Nermin Alibashiq, sekretar i Kuvendit të Komunës së Tuzit.

**PREDSJEDNIK SKUPŠTINE**
Fadil Kajoshaj

Në bazë të nenit 59 paragrafit 2 të Statutit të Komunës së Tuzit ("Fleta zyrtare e MZ – dispozitat komunale", nr. 24/19, 05/20) dhe nenit 139 dhe 140 të Rregullores mbi punën e Kuvendit të komunës së Tuzit ("Fleta zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr.29/19), në seancën e Kuvendit të komunës së Tuzit të mbajtur më _____, 2020, është sjellë:

PROGRAMI i punës së Kuvendit të komunës së Tuzit për vitin 2020

Programi i punës përcakton punët dhe detyrat e Kuvendit Komunal të Tuzit për vitin 2020, përmbajtjen e tyre themelore, bartësit e detyrave dhe afatet për shqyrtimin e çështjeve të caktuara në kompetencën e Kuvendit Komunal, të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Statut të Komunës, të cilat janë në funksion të zhvillimit të Komunës dhe plotësimit të nevojave me interes të drejtpërdrejtë dhe të përbashkët për banorët.

Programi është konceptuar në baza tremujore, në mënyrë që brenda çdo tremujori të përcaktohet rrethi i pyetjeve që i nënshtrohen rregullimit normativ (pjesa normative) dhe rrethi i pyetjeve që kanë karakter informues-analitik (pjesë tematike).

Bartësit e punëve dhe detyrave nga ky Program janë të detyruar dhe përgjegjës për përpunimin dhe përgatitjen me kohë të materialeve, dhe Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Kuvendit janë të detyruar të monitorojnë aktivitetet për zbatimin e këtij Programi.

Përveç këtij Programi të Punës, Kuvendi, nëse është e nevojshme, do të shqyrtojë çështje të tjera në kompetencën e tij, nëse lind nevoja.

TREMUJORSHI I DYTË PJESA NORMATIVE

1. PROPOZIM I VENDIMIT MBI NDRYSHIMIN E VENDIMIT MBI TË DREJTAT SOCIALE DHE FËMIJËVE

Hartuesi: Sekretariati për vetëqeverisje lokale

2. PROPOZIMI I VENDIMIT MBI REALIZIMIN E BARAZISË GJINORE

Hartues: Sekretariati për vetëqeverisje lokale

3. PROPOZIMI I PLANIT LOKAL AKSIONAR PËR ZHVILLIMIN E KULTURES

Hartuesi: Sekretariati për vetëqeverisje lokale

4. PROPOZIM I VENDIMIT MBI STRATEGJINË LOKALE PËR ARRITJEN E BARAZISË GJINORE

Hartuesi: Sekretariati për vetëqeverisje lokale

5. PROPOZIM I VENDIMIT MBI STRATEGJINË LOKALE PËR ZHVILLIM DHE AVANCIMIN E SPORTIT

Hartuesi: Sekretariati për vetëqeverisje lokale

6. PROPOZIM I VENDIMIT MBI NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E VENDIMIT MBI RËNDIN KOMUNAL

Hartuesi: Drejtoria për ndërtim, pronë dhe përfaqësim

7. PROPOZIM I VENDIMIT MBI NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT MBI RRUGËT KOMUNALE DHE TË PAKATEGORIZUARA NË TERITORIN E KOMUNËS SË TUZIT

Hartuesi: Drejtoria për ndërtim, pronë dhe përfaqësim

8. PROPOZIM I VENDIMIT MBI NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E VENDIMIT MBI MIRËMBAJTJEN E PASTERTISË

Hartuesi: Drejtoria për ndërtim, pronë dhe përfaqësim

9. PROPOZIM I VENDIMIT MBI NXITJEN E INVESTIMEVE NË ZHVILLIMIN E BUJQËSISË

Hartues: Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural

10. PROPOZIM I VENDIMIT TË MASAVE NXITËSE PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË NË KOMUNËN E TUZIT

Hartues: Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural

11. PROPOZIM I VENDIMIT MBI MASAT NXITËSE MBI ZHVILLIMIN RURAL NË KOMUNËN E TUZIT

Hartues: Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural

12. PROPOZIM I VENDIMIT MBI MASAT NXITËSE MBI RUAJTJEN E MJEDISIT NË KOMUNËN E TUZIT

Hartues: Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural

13. PROPOZIM I VENDIMIT MBI MASAT NXITËSE MBI MONUMENTET KULTURORE "KANIONI I LUMIT CEM".

Hartues: Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural

14. PROPOZIM I VENDIMIT MBI DHËNIEN E PËLQIMIT NË ÇMIMIN E SHËRBIMEVE
Hartues: SH.P.K. "KOMUNALNO/KOMUNALE" TUZI

PJESA TEMATIKE

1. RAPORT MBI PUNËN E KRYETARIT TË KOMUNËS DHE PUNËN E ORGANEVE TË ADMINISTARTËS LOKALE DHE SHËRBIMIT NË VITIN 2019.

Hartues: Shërbimi i Kryetarit të Komunës

2. RAPORT MBI PUNËN E VEPRIMTARISË SË ORGANIZATËS TURISTIKE TË KOMUNËS SË TUZIT PËR VITIN 2019.

Hartues: Organizata turistike e Tuzit

3. INFORMACION MBI PËRGADITJEN E SEZONIT TURISTIK NË KOMUNËN E TUZIT PËR VITIN 2019.

Hartues: Sekretariati për vetëqeverisje lokale

4. RAPORT MBI REALIZIMIN E VENDIMIT MBI MËNYREN E SHPËRNAMJES SE MJETEVE NGA BUXHETI I KOMUNËS SË TUZIT PËR VITIN 2019 TË DESTINUARA PËR BUJQËSINË

Hartuesi: Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural

5. RAPORT MBI PUNËN E POLICISË KOMUNALE PËR VITIN 2019.

Hartues: Policia Komunale

TREMUJORSHI I TRETË PJESA NORMATIVE

1. PROPOZIM I VENDIMIT MBI KRITERET, MËNYRËN DHE PROCESIN E SHPËRNDAMJES SË MJETEVE PËR PËRKRAHJEN E AFARIZMIT TË FEMRËS

Hartues: Sekretariati për vetëqeverisje lokale

2. PROPOZIM I VENDIMIT MBI DHËNIEN ME QIRA TË TRUALLIT NË PAJTIM ME PLANIN E VENDOSJES SË OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË TERITORIN E KOMUNËS SË TUZIT

Hartues: Drejtoria për ndërtim, pronë dhe përfaqësim

3. PROPOZIMI I VENDIMIT MBI DHËNIEN NË PËRDORIM TË PRONËS NË PRONËSI TË KOMUNËS SË TUZIT PA KOMPENSIM

Hartues: Drejtoria për ndërtim, pronë dhe përfaqësim

4. PROPOZIM I VENDIMIT MBI HARTIMIN E KADASTRES SË NDOTËSVE TË KOMUNËS SË TUZIT

Hartues: Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural

5. PROPOZIM I VENDIMIT MBI CAKTIMIN E ZONAVE AKUSTIKE DHE HARTIMIT TË PLANIT PËR MBROJTJE NGA ZHURMA NË KOMUNËN E TUZIT

Hartues: Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural

6. PROPOZIM I VENDIMIT MBI ZGJEDHJEN E LOKACIONIT PËR GRUMBULLIMIN E PËRKOHSHËM TË MBETJEVE NDERTIMORE

Hartues: Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural

PJESA TEMATIKE

1. RAPORT NGA FUSHA E BUJQËSISË PËR VITIN 2019.

TREMUJORSHI I KATËRT PJESA NORMATIVE

1. PROPOZIM I STRATEGJISË LOKALE PËR PËRFSHIRJEN E POPULLATES ROME DHE EGJIPTIANE

Hartues: Sekretariati për vetëqeverisje lokale

2. PROPOZIM I VENDIMIT MBI KUSHTET DHE MËNYRËN E SHFRYTËZIMIT TË AMBIENTEVE ZYRTARE NGA ANA E PËRSONAVE TË TRETË

Hartues: Drejtoria për ndërtim, pronë dhe përfaqësim

3. PROPOZIM I HARTIMIT TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT BUJQËSOR DHE RURAL TË KOMUNËS SË TUZIT PËR VITIN 2020-2024

Hartuesi: Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural

4. PROPOZIM I VENDIMIT MBI DHËNIEN E PËLQIMIT NË KONTRATËN MBI VERIFIKIMIN E PUNËVE TË PAJISJES ME UJË

Hartues: SH.P.K. "KOMUNALNO/KOMUNALE TUZI/TUZ".

5. PROPOZIM I PROGRAMIT TË PUNËS MBI BUXHETIN E KOMUNËS SË TUZIT PËR VITIN 2021

Hartues: Kryetari i Komunës

6. PROPOZIM I PROGRAMIT TË PUNËS KK TË TUZIT PËR VITIN 2021

Hartues: Kryetari i Kuvendit

7. PROPOZIMI I PROGRAMIT TË PUNËS SË ORGANIZATËS TURISTIKE TË TUZIT PËR VITIN 2021

Hartues: Organizata Turistike e Tuzit.

8. PROPOZIMI I PROGRAMIT TË PUNËS SË SH.PK "KOMUNALNO / KOMUNALE"
TUZI / TUZ PËR VITIN 2021

Hartues: SH.P.K. "KOMUNALNO / KOMUNALE" TUZI / TUZ

9. PROPOZIMI I PROGRAMIT TË RREGULLIMIT HAPËSINOR TË KOMUNËS SË TUZIT
PËR VITIN 2021.

Hartues: Sekretariati për rregullim dhe planifikimin hapësinor dhe shërbimet komunale.

PJESA TEMATIKE

1. INFORMACIONE MBI GJENDJEN E MBROJTJES PRIMARE SHËNDETËSORE TË
KOMUNËS SË TUZIT

Hartues: Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural.

2. INFORMACION MBI VEPRIMET E NDËRMARRURA LIDHUR ME GJUETINË NË
KOMUNËN E TUZIT.

Hartues: Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural.

3. RAPORT MBI AKTIVITETET E REALIZUARA NË ZBATIMIN E PLANIT AKSIONAR
PËR TË RINJTË PËR PRIUDHËN 2020-2021

Hartues: Sekretariati për vetëqeverisje lokale

4. RAPORT MBI AKTIVITETET E REALIZUARA NË REALIZIMIN E VENDIMIT MBI
PJESËMARRJEN E POPULLSISË LOKALE NË KRYERJEN E PUNËVE PUBLIKE.

Ky Program do të publikohet në "Fletën zyrtare të Malit të Zi, - dispozitat komunale".

Numër: 02-030/20-
Tuz, _____2020

KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT
KRYETARI,
Fadil Kajoshaj

ARSYETIM

Baza ligjore për sjelljen e Programit të punës së Kuvendit të Komunës së Tuzit, është caktuar në nenin 59 paragrafin 2 të Statutit të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale", numër 24/19,05/20) dhe nenit 139 të Rregullores mbi punën e Kuvendit të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale" nr. 29/19) me të cilin është paraparë që Kuvendi sjellë Programin e punës për vitin kalendarik dhe se me Programin e punës caktohen punët dhe detyrat e Kuvendit dhe përmbajtja themelore e tyre, bartësit e punëve dhe afatet për shqyrtim të çështjeve të veçanta. Në pajtim me nenin 140 të Rregullores mbi punën e Kuvendit të Komunës së Tuzit propozimet dhe mendimet mbi çështje të cilat duhen renditur në Programin e Punës së Kuvendit, kryetari i Kuvendit fiton nga kryetari i Komunës, organeve të administratës lokale, trupave punuese të Kuvendit, klubeve të këshilltarëve, shërbimeve publike, bashkësive lokale dhe organizatave jo qytetare. Kryetari i Kuvendit shqyrton propozimet e arritura dhe përcakton propozimin e Programit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin kalendarik të cilin ia dorëzon Kuvendit në shqyrtim.

Arsyet për sjellje:

Me program të punës janë përcaktuar veprimtaritë normative, programore dhe analitike gjatë vitit 2020. Në pajtim me propozimet e dorëzuara dhe me mendimet mbi çështje të posaçme të cilat duhet të ndërfiten në Programin e punës, Kryetari i Kuvendit ka caktuar Propozimin e Programit të punës së Kuvendit të Komunës së Tuzit për vitin 2020 dhe ia ka dorëzuar Kuvendit në shqyrtim dhe për vendim.